



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3433/Prot.
1

Tiranë, më 17.6. 2021

URDHËR

NR. 166, DATË 17.6.2021

PËR

CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT DHE MBARIMIT TË VITIT AKADEMIK
2021 – 2022, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, germës “i” të pikës 2 të nenit 7 dhe të pikës 1 të nenit 87 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e Vitit Akademik 2021 – 2022, në institucionet e arsimit të lartë, në datën 11 tetor 2021 dhe mbarimin e tij në datën 30 shtator 2022.
2. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet “Trajtimi i Studentëve” sh. a., listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

